



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

**RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VLERËSIM TË MËSIMIT ONLINE NGA
STAFIT AKADEMIK DHE STUDENTËT E UNIVERSITETIT 'KADRI
ZEKA', PËR SEMESTRIN VEROR TË VITIT 2019/2020**

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Fitore Malaj-Abdyli

<u>Hyrje</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>1. Metodologjia e hulumtimit</u>	4
<u>1.1. Qëllimi i hulumtimit</u>	4
<u>1.2. Metodatat e hulumtimit</u>	4
<u>2. Rezultatet e Hulumtimit</u>	5
<u>2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit</u>	5
<u>2.2. Analiza e pyetësorëve</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>2.2.2. Qëndrimet e Mësimdhënësve të UKZ-së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>2.2.3. Qëndrimet e studentëve të UKZ-Së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor</u>	8
<u>3. Përfundimet dhe rekomandimet</u>	<u>10</u>

Hyrje

Pas situatës së krijuar me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, që shkaktoi edhe mbylljen e profesorëve dhe të studentëve nëpër shtëpi, ashtu sikur në të gjitha IAL-të në Kosovë edhe UKZ ka aplikuar E-mësimin, duke e realizuar përmes platformave të ndryshme online.

Duke e ditur se tashmë të gjithë Profesorët dhe Asistentët e Universitetit tonë i kanë aplikuar format e të mësuarit në distancë/E-mësimin. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, në bashkëpunim me Menaxhmentin e UKZ-së si dhe Komisionin për Sigurim të cilësisë ka kërkuar informacione në lidhje me këtë formë të mësimit të aplikuar në UKZ.

Lidhur me këtë kemi realizuar një hulumtim, me qëllim të sigurimit të dhënave nga përvojat e mësimit dhe studentëve për periudhën e semestrit veror, për zbatimin të mësimit në distancë/E-mësimin.

Në kuadër të kësaj kemi hartuar pyetësin të bazuar në organizimin e mësimit në kohë pandemie. Janë hartuar dy pyetësorë, një për mësimit dhe një për studentët. Me anë të tyre ne kemi bërë matjen e realizimit të detyrave dhe përgjegjësi themelore të profesorit karshi studentit, gjatë mbajtjes së mësimit online, si dhe këndvështrimin e studentit kundrejt këtij realizimi.

1. Metodologjia e hulumtimit

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e vështërsive gjatë realizimit të plan programeve mësimore të mësimdhënësve në UKZ në formë virtuale. Përdorimin e platformave online, kyçjen e studentëve, mënyrën e realizimit të plaprogramit mësimor si tërësi duke përfshirë edhe ushtrimet, Përdorimi i teknologjisë si përvojë e re e mësimdhënies. Gjithashtu ky hulumtim shpreh qëndrimin studentëve rreth mënyrës së re të organizimit të mësimit si mbarëvajtjes së procesit mësimor, pjesëmarrjes në ligjërata, interaksionit brenda ligjëratës, mbajtjes së konsultimeve si dhe përshtatjes së studentëve me mësimin në distancë.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim të dhëna të cilat tregojnë shkallën e veprimit të mësimdhënësve dhe studentëve në rrethana të reja të krijuara si pasojë e Covid-19

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t'u shërbejnë Stafit Akademik si dhe menaxhmentit të lartë të UKZ-së për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit për periudhën e Semestrin veror 2019/2020.

1.2. Metodatat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Shpërndarja e pyetësorëve u bë përmes platforës google forms. Pyetësorët u shpërndanë në formë elektronike tek i gjithë stafi akademik dhe studentët e Universitetit Kadri Zeka, gjatë periudhës 29 Maj - 5 Qershor të vitit 2020.

2. Rezultatet e Hulumtimit

2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit

Në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë të UKZ-së si dhe Komisionin për Sigurimin e Cilësisë kemi hartuar pyetësonin sipas Shkallës së Likertit, ku mësuesit dhe studentët për secilin konstatim është dashur të klikojnë në rrethë 5,4,3,2,1 (5=pajtohem plotësisht; 4=pajtohem; 3=nuk e di; 2=nuk pajtohem; 1=aspak nuk pajtohem).

Pyetësoni për mësuesit është shpërndarë nga zyrja për Zhvillim AkademiK dhe Cilësi

Ndërsa shpërndarjen e pyetësonit për studentët e kanë bërë vetë studentët (anëtarë të Parlamentit Studentorë)

Pyetësonit të shpërndarë i janë përgjigjur 78 mësuesit kurse studentët e UKZ-së kanë plotësuar 378 pyetësor gjithsej.

Regjistrimi i të dhënave të pyetësorëve në formë elektronike, është realizuar në Zyrën për Zhvillim AkademiK dhe Cilësi.

Për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit si dhe publikimin e rezultateve ka punuar kryesisht Zyra për Zhvillim AkademiK dhe Cilësi në konsultim me Komisionin për Sigurimin e Cilësisë.

2. 2. Analiza e pyetësorëve

2.2.1. Qëndrimet e Mësimdhënësve të UKZ-së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Tabela 1 Rezultatet e pyetësorit për Staf Akademik të shprehura me mesatare

Konstatimet		Mesatarja
1	Kam pasur informacione/njohuri për organizimin e mësimit në distancë /E-mësimit	3,78
2	Me lehtësi kam filluar të aplikoj mësimin online me stuentët e mi	4,28
3	E-mësimin e kam realizuar me aplikacionin/Platformën Googel Meet	4,50
4	Vijueshmëria e mësimit online ka qenë mjaft e kënaqshme	4,00
5	Kemi mbajtur evidenca të rregullta për studentët të cilët janë kycur dhe angazhuar ne mësim në distancë /E-mësim	4,14
6	Kam arritur që në plotni të realizoj planprogramin mësimor për këtë semestër	4,17
7	Mësimin online i ka munguar interaksioni	2,72

8	Realizimi i ushtrimeve ishte vështërsi gjatë mbajtjes së E-mësimit	2,69
9	Mësimi online ishte përvojë e mirë, në avancimin e përdorimit të teknologjisë nga ana jonë.	4,00
10	Mësimin online do ta praktikoj edhe më tutje	4,08

Tabela 1 shpreh qëndrimet e mësimeve të UKZ-së, lidhur me organizimin e mësimit online

Nga mësimeve janë kërkuar përgjigje në pohimet e parashtruara sipas shkallës së Likertit (nga 1- 5). Në përgjigjet e dhëna shihet se nuk ka dallime esenciale në qëndrimet e tyre . Në konstatimin e parë se sa mësimeve kanë pasur njohuri për organizimin e mësimit në distancë mësimeve janë shprehur në një shkallë mesatare relativisht të ulët rreth 3.78, kjo tregon që një pjesë e konsiderueshme e mësimeve nuk kanë pasur njohuri më herët. Me shkallë më të lartë mesatare mësimeve shprehen në konstatimin e dytë lidhur me lehtësitë në aplikimin e mësimit online (mesatarja 4,28). Me mesatare 4.50 mësimeve janë dakord me përdorimin e platformës Google Meet. Në pohimin 4 lidhur me vijueshmërinë e studentëve, mësimeve shprehen të kënaqur me shkallë mesatare 4.00, kjo tregon një përfshirje të kënaqshme të studentëve në ligjëratat. Gjithashtu numër i madh i mësimeve tregojnë se kanë mbajtur evidence të rregullt lidhur me vijimin e studentëve në ligjëratat (Pohimi 5, mesatarja 4,14) Një ngritje të ulët në mesatare shohim tek pohimi 6, me mesatare të shprehur 4,17, mësimeve deklarohen se kanë arritur të realizojnë planprogramin mësimor në plotni. Një ulje të theksuar e shohim tek pohimi 7 ku konstatimi se mësimit online i ka munguar interaksioni, mësimeve shprehen të pakënaqur, me mesatare 2,72. Këto të dhëna tregojnë se vështërsitë në realizimin e ligjëratave ishin evidente. Të dhënat në pohimin 8 tregojnë se mësimeve në masë të madhe kanë pasur vështërsi në realizimin e ushtrimeve me student (Mesatarja 2,69). Organizimi i mësimit online konsiderohet se ishte përvojë e mirë në avancim të përdorimit të teknologjisë ,keto e tregon shkalla e mesatares 4,00 në pohimin 9, ndërsa mësimeve në masë të madhe shprehen

të gatshëm se do të praktikojnë edhe më tutje mësimin online na tregojnë të dhënat në krahimin 10, me mesatare 4,08.

2.2.2. Qëndrimet e Studentëve të UKZ-së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Tabela 2 Rezultatet e pyetësorit për Studentë të shprehura me mesatare

Konstatimet		Mesatarja
1	Kam pasur informacione/njohuri për organizimin e mësimin në distancë /E-mësimin	3,57
2	E kam mirëpritur fillimin e mësimin në distancë /E-mësimin	3,63
3	Nuk kam pasur vështërsi në kyçjen e mësimin online	3,61
4	Mësimdhënësit kanë mbajtur evidencë të rregullt për pjesëmarrjen e studentëve në ligjërata	3,31
5	Mësimdhënësit kanë realizuar planprogramin mësimor në plotni	3,19
6	Përmes platformës online kam mbajtur konsultimet e nevojshme me profesor	3,23
7	Mësimin online i ka munguar interaksioni	3,52

8	Realizimi i ushtrimeve ishte vështërsi gjatë mbajtjes së E-mësimit	3,36
9	Mësimi online ishte përvojë e mirë, në avancimin e përdorimit të teknologjisë nga ana jonë.	3,36
10	Mësimin online do te duhej ta praktikojme edhe më tutje	2,95
	Mesatarja e përgjithsme	3,41

Në tabelën 2 janë shprehur me mesatare qëndrimet e studentëve lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor të mbajtur online përmes platformave elektronike.

Siç shihet në pohimin 1, studentët me një mesatare rreth 3,57 shprehen se kanë pas njohuri edhe më parë për organizimin e mësimit në distancë. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i studentëve shprehen se e kanë mirëpritur fillimin e E- mësimit (Pohimi 2, Mesatarja 3,63). Sipas vlerës së mesatares tek pohimi 3 shohim se një pjesë e madhe e studentëve të UKZ-së nuk kanë pasur vështërsi në kyçjen në mësim online (Mesatarja 3.61) . Qëndrimi i studentëve karshi konstatimit se mësimdhënësit kanë mbajtur evidencë të rregullt për vijueshmerine ne ligjërata shprehet në një shkallë më të ulët vlerësimi (Pohimi4, Mesatarja 3.31) Një ulje të vogël në vlerësim e shohim edhe tek pohimi 5, nga këndvështrimi i studentëve lidhur me realizimin e planprogramit mësimor në plotni, shkolla e vlerësimin në mesatare është 3.19. Dallim të vogël në qëndrime shohim edhe tek konstatimin 6 ku studentët vlerësojnë me mesatare 3.23 mbajtjen online të konsultimeve me mësimdhënësit e tyre. Gjithashtu edhe në konstatimin 7 dhe 8 se ligjeratave u ka munguar interaksioni si dhe realizimi i ushtrimeve ka qenë vështërsi përmes platformës online , studentët kanë një qëndrim të shprehur me mesatare jo të lartë (Mesataret 3,52 dhe 3,36)

Me konstatimin 9, se mësimi online ishte përvojë e mirë për ta, studentët nuk shprehen entuziastë. Vlerësimi i tyre në shkallë mesatareje është 3.70.

Një ulje të theksuar në vlerësim shohim në qëndrimin e studenteve lidhur me vazhdimin e mësimit online, tek pohimi 10 ku shkolla e vlerësimin është 2.97.

3.Përfundimet dhe rekomandimet

Duke u bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi si dhe analizën të rezultateve të dy pyetësorëve për mësimdhënës dhe për studentë, mund të konkludojmë se dallimet në qëndrime ndërmjet studentëve dhe mësimdhënësve të UKZ-së janë evidente. Organizimi i mësimit online nga të dy palët shihet në këndvështrime jo të njëjta . Këtë e tregon edhe mesatarja e përgjithshme Sipas rezultatit shihet se mësimdhënësit janë shprehur më të kënaqur në mënyrën e re të organizimit të mësimit, Mesatarja e përgjithsme e tyre është 4,08. Ndërsa më pak të kënaqur janë shprehur studentët, qëndrimi i tyre në mesatare të përgjithshme është 3,41.

Qëndrimet e studentëve të shprehura ndaj mësimdhënies online në të gjithë Universitetin, pothuajse kryesisht janë të përafërta me ndonjë dallim të vogël në përqindje, pra të gjitha janë mbi 3 e nën 4, Përveç në konstatimin 10 ku shkalla e vlerësimit është më e ulët, nën 3. Sipas rezultateve, studentët nuk tregojnë gatishmëri për të vazhduar më tutje që mësimi të organizohet përmes platformave digjitale.

Rezultatet tregojnë se me një diferencë të dukshme më të lartë se sa studentët, janë shprehur profesorët. Ata shprehen entuziastë në përdorimin e teknologjisë në organizimin e mësimit. Këtë e tregon edhe vlerësimi në shumicën e konstatimeve i cili është mbi 4, përveç në konstatimet se ligjëratave iu ka munguar interaksioni si dhe realizimi i ushtrimeve ka hasur në vështërsi ku ata kanë një shkallë vlerësimi më të ulët (Pohimi 7-2,72, Pohimi 8-2,69).

Vlen të theksohet se në konstatimin e fundit se a duhet të praktikojnë mësimin online edhe më tutje, shprehet një dallim i theksuar në vlerësim ndërmjet mësimdhënësve dhe studentëve, kjo tregohet me mesatare të ulët, të shprehur me 2.95 tek studentët, si dhe 4,08 tek mësimdhënësit.

Nga rezultatet e dala nga ky hulumtim mund të konstatojmë se mësimdhënësve të UKZ-së mënyra e re e organizimit të mësimit u solli risi dhe një komoditet të mësidhënies, për deri sa studentët nuk e pritën edhe aq mirë për shkak të rrethanave të kufizuara në nxënien e tyre.

- Të gjenden forma që mësimdhënia online të organizohet në grupe më të vogla në mënyrë që të ketë interaksion brenda ligjëratve
- Të krijohen mundësitë që së paku ushtrimet të mbahen në objekt universitar, duke respektuar rregullat e ISHPK-se
- Nga menaxhmenti i NJA të monitorohet strikt vijueshmëria studentëve si dhe mbajtja e konsultimeve . Gjithashtu të mbahet evidencë me të dhënat nga zyra e IT
- Të krahasohen rezultatet e studentëve të semstrit veroror 2019/2020 me rezultatet e studentëve të semestrit veror 2018/2019

